



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.388/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Xhezide Dragusha, nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të palejuara ankesat ZL.A.nr.388/2017, ZL.A.nr.389/2017, ZL.A.nr.390/2017, ZL.A.nr.391/2017, ZL.A.nr.392/2017 dhe ZL.A.nr.393/2017, ZL.A.nr.394/2017 e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Sanije Dubova nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 7 (shtatë) ankesa nga Xhezide Dragusha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotimi në Mazgit të Ulët nr.1520e/01R; në shkollën fillore “Ibrahim Rugova” Obiliq; në Vendvotimit 1505 në Kastriot; në Plemetin vendvotimi 1511e/01D; në shkollën fillore “Fazli Graiqevci” vendvotimi 1508e/01D, në Milloshevë, vendvotimi 1502e/02D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.388/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesat janë të pa lejuara**

Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të

parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses nuk e paragjykon çështjen se ankueses i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.388/2017 më datën 24.10.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*